



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

---

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr. 326/7 Prot.

Tiranë, më 16.11.2020

**V E N D I M**  
**Nr. 122, Datë 16.11.2020**

**PËR**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË, PËR PROJEKTIN**  
**“NDËRTIMI I BULEVARDIT VERIOR DHE REHABILITIM I LUMIT TË**  
**TIRANËS”, “MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”**  
**për periudhën nga data 01.10.2017 deri më datën 30.04.2020.**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tiranë për projektin “Ndërtim i Bulevardit Verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës” me objekt “Auditim Përputhshmërie”, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e zbatimit të udhëzuesve të donatorëve për realizimin e disbursimeve, zbatimin e kontratave dhe vendimmarrjeve në lidhje me problematikat që dalin gjatë zbatimit të tyre, u konstatuan devijime/shkelje të këtyre udhëzuesve, të cilat nuk janë materiale por të përhapura dhe justifikojnë dhënie të opinionit të modifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Tiranë, për Projektin “Ndërtim i Bulevardit Verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës”, sipas programit të auditimit nr. 326/1 prot., datë 30.04.2020, për veprimtarinë nga data 01.10.2017 deri më datë 30.04.2020.**

**II.** Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

### **A. OPINIONI I AUDITIMIT**

#### **Për Njësinë e Zbatimit të Projektit.**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Projektit “Ndërtim i Bulevardit Verior dhe rehabilitim i Lumit të Tiranës”, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat Njësia e Zbatimit të Projektit, menaxhon proceset e zbatimit. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

#### **Opinionin e modifikuar.**

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Bashkia Tiranë për Projektin “Ndërtim i Bulevardit Verior dhe rehabilitim i Lumit të Tiranës”, rezultuan devijime materiale sasiore dhe cilësore nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur nuk janë materiale por të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një Opinioni të modifikuar.

#### **Baza për opinionin e modifikuar.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik *ISSAI 4000*<sup>1</sup>, me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në INTOSAI - P10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 130 “Kodi Etik”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetin për subjektin e audituar.

#### **Nga evidencat e marra për veprimtarinë e projektit, rezultuan disa mangësi dhe parregullsi që konsistojnë në:**

- Projektin ka kapërcyer afatet e parashikuara për përfundimin. Vonesë më e theksuar ka rezultuar në Kontratën e Ndërtimit të Bulevardit Verior, periudha e përfundimit të të cilit është shtyrë për një periudhë 55 muaj.
- Në rritjen e kostos së projektit si pasojë e ndryshimeve, një ndikim negativ të konsiderueshëm ka rritja e shërbimeve konsulentë (për mbikëqyrjen e punimeve). Pavarësisht domosdoshmërisë së këtyre shpenzimeve, të cilat janë rritur si pasojë e zgjatjes së afatit të

<sup>1</sup>Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

përfundimit të kontratave të punimeve civile, vlera e rritur e tyre deri në momentin e auditimit në shumën 2.57 milionë Euro. Krahas rritjes së vlerës së shërbimeve konsulente nga shtyrjet e afatit të përfundimit të kontratës, janë miratuar shpenzime për kohë mbi kohë normale të punës me vlerë 204,620 Euro.

-Si pasojë e vonesave në zbatimin e kontratave, rriten edhe shpenzimet për disa shërbime, të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtje dhe operim automjetesh, mirëmbajtje dhe operim i zyrave në dispozicion të konsulentit, etj., të cilat nuk japin impakt në investimin e realizuar. Vlera e shpenzuar për këto shërbime në shumën 635,998 Euro, përbën rritje të kostos së projektit.

- Janë konstatuar mangësi në përcaktimin e çmimeve të reja dhe në zbatimin e punimeve, me efekt negativ financiar me vlerë 50 mijë Euro.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Për projektin “Bulevardit Verior dhe të Rehabilitimit të Lumit të Tiranës”, referuar aktit të marrëveshjes së financimit mungon Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD), i cili është një nga dokumentet me thelbësore/rëndësishme të projektit, ku përcaktohen paraprakisht se sa është kosto totale e projektit, si dhe përfitimet, matja e arritjeve të pritshme me indikatorët përkatës me përfundimin e projektit, grafiku i ecurisë së projektit dhe grafiku i disbursimeve. Mungesa e këtij dokumenti duke mos patur indikatorë të matshëm për realizimin e objektivave të përgjithshëm me qëllim realizimin sa më me efikasitet të projektit e bën të vështirë procesin e vlerësimit të realizimit të objektivave të projektit (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:-** Bashkia Tiranë dhe Njësitë e Zbatimit të Projekteve, të marrin masa që në të ardhmen të sigurojnë dhe të plotësojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për projektet me financime të huaja, duke filluar me dokumentet e fazës fillestare (studimi i fizibilitetit), si dhe Dokumentet Vlerësuese deri me dokumentet e mbylljes së projekteve, si dhe të kërkojnë zbatimin e tyre.

*Në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për projektin “Bulevardit Verior dhe të Rehabilitimit të Lumit të Tiranës”, kontributi i Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit ka mbuluar plotësisht 100% rehabilitimin e lumit dhe bregut të tij, ndërtimin e bulevardit verior (pjesa e parë) dhe shërbimet e konsulencës teknike të përshkruara në raportin e vlerësimit të projektit (studimi i fizibilitetit), të cilat përfaqësojnë 50% të gjithë projektit të zhvillimit të pjesës veriore të qytetit. Objektivi i projektit është që të ndihmojë përmirësimin e ujëmbledhësit dhe bregut të Lumit të Tiranës si dhe mbështetjes së investimeve, ambienteve të kohës së lirë dhe turizmit të zonës. Referuar marrëveshjes së financimit, pjesët e tjera të projektit që përbëhen kryesisht nga rruga e unazës, pjesa e dytë e bulevardit, punimet infrastrukturore etj., duhet të mbulohen nga Bashkia e Tiranës në një fazë të dytë. Objektivi i Përgjithshëm i projektit synon të sjellë zgjidhje afatgjatë për zhvillimin e qytetit, në lidhje me transportin, trafikun, infrastrukturën urbane dhe mjedisin të cilat do të mund të shihet pas përfundimit të fazës së dytë të zhvillimit të Bulevardit, fazë për të cilën drejtoria e menaxhimit të projekteve nuk dispononte informacione lidhur me asnjë nisem financiare në lidhje me kryerjen e këtij investimi, çeljen e fondeve në tërësi për zhvillimin e projektit referuar Masterplanit të Ri të Zhvillimit Urban. Nuk rezultoi asnjë studim paraprak mbi pjesën e dytë të projektit, nuk është përcaktuar se kur mund

të filloj dhe të arrij të përfundoi kjo pjesë e projektit. Vonesat më zhvillimin e fazës së dytë mund të sjellin kosto shtesë për mirëmbajtjen e fazës së parë si pasojë e amortizimit të kësaj pjese dhe gjithashtu ndikon ndikon në mos realizimin e objektivit të pjesës së parë të projektit (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:-** Bashkia Tiranë të marrë masa që të analizojë situatën dhe përshpejtojë hapat për sigurimin e financimit dhe zhvillimin e fazës së dytë të projektit me synimin që investimi të jetë sa më efektiv dhe eficient, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përgjithshëm i projektit i cili i përfshin zgjidhja afatgjatë për zhvillimin e qytetit, në lidhje me transportin, trafikun, infrastrukturën urbane dhe mjedisin.

*Brënda vitit 2020*

**3. Gjetje nga auditimi:** Projekti “Ndërtimi i Bulevardit Verior të Tiranës” ka kërkuar një kohë të konsiderueshme për zbatimin e tij ku gjatë realizimit të dy kontratave të lidhura për zbatimin e komponentëve të projektit Komponenti 1- Kontrata me objekt “Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës, të bankinave dhe përfshirë të gjitha punimet ndërtimore” lidhur në datë 17.01.2014 dhe komponenti 2- kontrata me objekt “Ndërtimi i Bulevardit Verior të Tiranës dhe punimet civile respektive” lidhur në datë 06.09.2013, janë nevojitur ndryshime të projektit, të cilat kanë dalë kryesisht për masa të paparashikuara në fazën fillestare, problematika me infrastrukturën e rrjeteve nëntokësore për zonën ku nuk ishin kryer shpronësimet si edhe për arsye të përshtatjes me planet vendore zhvillimore të qytetit, shtesa të cilat kanë sjellë si pasojë edhe shtyrjen e kontratës së konsulentit, duke mos vënë në efikasitet investimin (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Njësia e zbatimit të projektit në Bashkinë Tiranë, të marrë masa për të parandaluar në të ardhmen mos respektimin e afatit të realizimit të projektit në tërësi, si dhe shmangien e ndryshimeve disa here gjatë zbatimit të tij, në mënyrë që fondet e parashikuara për projektin të përdoren me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet.

*Në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** -Nga auditimi i aplikimeve për pagesa konstatohet se për aplikimet për IPC nga numri 11-18 mungon bashkëlidhur kopja e certifikatave të pagesave të ndërmjetme (IPC). Po ashtu për IPC-në 18 ka një vonesë prej 13 ditësh në procedurën e aplikimit për pagesë. Në aplikimin për pagesë të “Deklaratës të Përfundimit të Punimeve numër 3”, ka vonesë në aplikim prej 23 ditësh në procedurën e aplikimit për pagesë. Këto vonesa sjellin shkelje të afatit të përcaktuar në Procedurat Standarte të veprimit, pa efekt financiar.

-Po ashtu, referuar PSV lidhur me aplikimet për pagesë, ku shpjegohet hap pas hapi radha e veprimtarisë dhe afatet kohore lidhur me këtë pikë, nga grupi i auditimit konstatohet se në asnjë rast nuk është zbatuar radha e aplikimit të procedurave. Referuar dokumentacionit të audituar konstatohet se si fillim është kryer aplikimi për pagesë drejtuar donatorëve, dhe përgjithësisht pas 5-6 ditëve më vonë i është dërguar Memo Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Kjo bie në kundërshtim me hapat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të PSV. Certifikatat e pagesave të ndërmjetme (IPC) janë të firmosura nga kontraktori, Bashkia Tiranë (përfaqësuar nga Drejtori i Financimeve të Huaja dhe përgjegjësi i sektorit të zbatimit të projekteve) si dhe nga mbikëqyrës i punimeve.

-Lidhur me raportimin mujor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nga grupi i auditimit janë konstatuar disa vonesa në raportim, konkretisht në korrik 2018, qershor, gusht, dhjetor

2019, dhe mars 2020, në kundërshtim me hapat e PSV, të përcaktuara në pikën 3. Këto vonesa sjellin për pasojë parregullsi procedurale, pa efekt financiar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1-Rekomandimi:-** Nga Drejtoria e Implementimit të Investimeve të Huaja të merren masa për shmangien e vonesave dhe parregullsive procedurale në aplikimin e pagesave të IPC-ve, ndjekja hap pas hapi e hallkave përkatëse, si dhe në raportimin në Ministrinë e Financave.

*Në vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi kostatohet se situata e likuidimit të TVSH-së për kontratat e projektit, paraqitet si më poshtë:

Pagesa e TVSH për kontratën e parë, nga fillimi i projektit deri në IPC nr. 26 është në shumën 643,821,921.44 lekë.

Pagesa e TVSH për kontratën e dytë, nga fillimi i projektit deri në IPC nr. 19 dhe IPC Final është në shumën 688,931,635 lekë.

Pagesa e TVSH për kontratën e tretë, nga fillimi i projektit deri në IPC nr. 34 është në shumën 112,971,019 lekë.

Vlera totale e TVSH të paguar është 1,445,730,575.44 lekë.

Nga auditimi janë konstatuar vonesa në pagesë në lidhje me procedurat e rimbursimit të TVSH-së, për projektin për sa më sipër në vlerën 40,251,695 lekë (pra nuk është paguar akoma TVSH-ja), sa i takon kontratës “Ndërtimi i Bulevardit Verior Tiranës dhe punimet civile përkatëse” me Kontraktor “Copri Construction Enterprises, nga përfituesi Bashkia Tiranë. Po ashtu, janë konstatuar vonesa në aplikimin lidhur me rimbursimin e TVSH-së lidhur me faturat e situacioneve numër 24, 25, certifikatë finale segmenti 1 dhe deklaratës së përfundimit 3. Rimbursimi i TVSH-së lidhur me IPC 1, në vlerën 63,289,009 lekë, detyrim i lindur në 17.12.2013 lekë rezulton se është kryer në 15.10.2019, pas disa kërkesave nga ana e kompanisë që ka kryer punimet. Këto vonesa, të cilat kanë ardhur për shkaqe burokratike, rrisin riskun për pretendime nga ana e kontraktorit *(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1-Rekomandimi:-** Nga Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marren masa për ndjekjen pagesave në lidhje me likuidimin e TVSH-së, si dhe shmangien e vonesave.

*Në vazhdimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia e Zbatimit të Projektit/Bashkia Tiranë ka kërkuar shtyrjen e afatit të detyrimeve të parashikuara në Nenin 3, të marrëveshjes financiare (Tërheqja dhe Mënyrat e Përdorimit të Fondeve) lidhur me disbursimin nga data 31.12.2018 në datën 30.06.2020, me shkresën nr. 22927 datë 11.06.2018 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Janë bërë shtesa lidhur me kontratat, të cilat në vlerë financiare, e cila mbulohet nga projekti, paraqiten si më poshtë:

Me shkresën nr. 43744/1, datë 04.12.2017 është miratuar shtesa me Addendum nr.4 ku vlera totale e projektit ka shkuar në 30,038,755.11 Euro, nga 29,783,628 Euro.

Me shkresën nr. 20386/1, datë 22.05.2018 është miratuar shtesa me Addendum nr.5 ku është shtyrë me 11 muaj kontrata e kompanisë JV “P”, & “H”, “A Srl”, & “T. C. E. SpA”, Itali; dhe vlera totale e projektit ka shkuar 29,877,277.65 Euro, nga 26,391,568 Euro.

Me shkresën nr. 15792/5, datë 06.05.2019 është miratuar shtesa me Addendum nr.6 ku është shtyrë me 59 ditë afati i përfundimit të kontratës të kompanisë JV “P.”, & “H”, “A. Srl”, & “T. C. E. SpA”, Itali; ku vlera totale e projektit ka shkuar në 29,816,064.35 Euro, nga 29,783,628 Euro.

Kosto totale e projektit deri në përfundim të auditimit në terren, duke përfshirë dhe TVSH është 61,586,599.16 Euro.

Diferenca prej 2,997,916.91 Euro e mbetur për disbursim deri në datën 30.06.2020, është vlera që do të disbursohet në përfundim të garancisë të kontratave, sipas parashikimeve të marrëveshjes. Këto veprime bien në kundërshtim me Aktin normativ nr. 3, datë 03.05.2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit të Bulevardit Verior dhe të Rehabilitimit të Lumit të Tiranës”, neni 4, pika 4.04. *(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1-Rekomandimi:-** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, pranë Bashkisë Tiranë, të marrin masa për monitorimin, supervizionin dhe zbatimin e afateve të përcaktuara, në mënyrë që mos cenohet ecuria normale të projekteve në të ardhmen.

*Në vazhdimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të Kontratës së Shërbimeve Konsulente, rezulton se janë bërë largime të shpeshta të stafit teknik (inxhinierëve) të konsulentit. Largimet dhe punësimi i inxhinierëve të tjerë janë të parashikuara në termat e kontratave, por zëvendësimet duhet të bëhen me inxhinierë të cilët zotërojnë të njëjtat kualifikime ose më të larta. Në një rast, inxhinieri i larguar i caktuar në pozicionin e supervizionit të punimeve rrugore dhe me kriterin që duhet të jetë i diplomuar në “Infrastruktura rrugore”, është zëvendësuar me inxhinier të profilit “Ndërtesa civile dhe industriale”, jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në kontratë. Në dy raste zëvendësimi është bërë me ekspertë me kualifikime dhe eksperiencë më të ulët se ato të larguar. Angazhimi i ekspertëve pa kualifikimet e përcaktuara, ndikon në performancën e shërbimeve të supervizionit në këtë rast. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 30, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës *(Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1-Rekomandimi:-** Njësia e Zbatimit të Projektit, në rastin e zbatimit të kontratave të ngjashme dhe në vazhdimësi, duhet të monitorojë veprimtarinë e konsulentit në lidhje me stafin e emëruar dhe stafin që rekrutohet prej tij, duke mos pranuar ekspertë pa eksperiencën e përcaktuar në termat kontraktore, me qëllim sigurimin e shërbimeve konsulente dhe mbikëqyrje të punimeve cilësore, duke dhënë garanci për investitorin që punimet e parashikuara në kontrata janë realizuar në përputhje me projektin e zbatimit dhe ndryshimet përkatëse të miratuara.

*Vazhdimisht*

**8. Gjetje nga auditimi:** Kontratës së rehabilitimit të Lumit Tiranë i janë bërë disa ndryshime, një ndër të cilët ka të rritjen e qëndrueshmërisë së betonit të kanalizimeve të ujërave të zeza, për arsye se ato kanë në përbërje elementë kimikë të cilët ndikojnë negativisht në jetëgjatësinë e betonit dhe rrjedhimisht të kanalizimeve. Për realizimin e këtij procesi, i cili nuk ka genë

parashikuar është miratuar që në përbërje të betonit të përfshihet një element kimik (aditiv me bazë sulfati) i cili mbron kanalizimet nga gërryerja dhe shkatërrimi. Sasia e aditivit të përdorur është përcaktuar në masën 21588 m<sup>3</sup>, me çmim njësi 20 Euro/m<sup>3</sup> dhe vlerë 431,160 Euro.

Në dokumentet e audituara jepet sasia e përdorur, por nuk detajohen normat e caktuara, përqindja e sasisë që kërkohet për për 1 m<sup>3</sup> beton arme, sipas llojit të përdorur. Nuk përcaktohet metodologjia e përcaktimit të çmimit, përllogaritje kostoje, referenca etj., por është mjaftuar me propozimin e kontraktorit, pa asnjë dokumentacion që vërteton studimin e tregut, bazë referencë në çmime etj. Si pasojë e këtij veprimi nuk është bërë e mundur konkurrenca, sipas të cilës mund të përfitohej kosto më e ulët e realizimit të punimeve. Ky veprim është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.3.b “Vlerësimi” (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1-Rekomandimi:** - Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrin masa që në fazën e realizimit të projekteve të parashikohet përdorimi i materialeve për betone të cilat vendosen në ambiente që i nënshtrohen agjentëve kimikë, por edhe elementë të tjerë.

#### *Vazhdimisht*

**9. Gjetje nga auditimi:** Urdhër ndryshimi nr. 2 për Kontratën e rehabilitimit të Lumit të Tiranës, është miratuar sipas Vendimit të Këshillit Teknik nr. 7/1, datë 07.04.2017, me vlerë 5,259,505.6 Euro. Ky ndryshim ka të bëjë me shtesë në projekt me gjatësi 1.3 kilometër, me vlerë 3,509,700.6 Euro, si dhe gjelbërim i bankinave me vlerë 1,749,805 euro.

Në disa zëra të punimeve si më sipër ka devijime sa i takon respektimit të fazave të projekti. e mësipërme ka devijime të cilat kanë të bëjnë me kapërcim të fazave të projektit. Rezulton se janë parashikuar punime shtresë çakulli dhe binderi për rrugë aksesi, në ndihmë të realizimit të transportit të materialeve nga punimet, me vlerë 22,563 Euro, por që ka ndryshim destinacioni. Punimet nuk janë realizuar për rrugë aksesi, por rrugë në zonën afër lumit (në qendër të banuar). Ky veprim është në kundërshtim me Urdhër ndryshimin nr. 2.

Zëri i punimeve të gjelbërimit shtuar sipas VO nr. 2, është parashikuar të realizohet në fazën e dytë të projektit. Shtimi i këtij zëri të punimeve në këtë fazë të projektit është në kundërshtim me dokumentacionin e projektit (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1-Rekomandimi:** - Njësia e Zbatimit të Projektit, për projektet në vazhdimësi, të marrë masa për zbatimin e fazave të projektit sipas përshkrimeve në marrëveshjet përkatëse dhe në rastin e nevojës për ndryshime të cilat janë në dobi të proceseve të zbatimit, të argumentohen me qëllim arritjen e përfitimeve në dobi të komunitetit dhe zvogëlimin të kostove.

#### *Vazhdimisht*

**10. Gjetje nga auditimi:** Si pasojë e ndryshimeve të kontratës së rehabilitimit të Lumit të Tiranës është nevojitur përfshirja e punimeve të cilat nuk janë të ngjashme me punimet e përcaktuara në preventivin e tenderuar. Për aplikimin e çmimeve të reja, ku ka qenë e mundur është marrë për referencë VKM nr. 568 datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve të çmimeve teknike të punimeve të ndërtimit dha analizave teknike të tyre”. Manuallet, krahas kostonë së realizimit të punimeve, parashikojnë shpenzime të përgjithshme në masën 8 % dhe fitimi në masën 10 %, përqindje të përfshira në çmim pa asnjë ulje, duke qenë në kushtet e pamundësisë së tenderimit. Për këtë kontratë, punimet e realizuara më çmime jashtë preventivit është me vlerë 4.9 milionë Euro, ose 20.7 % të vlerës së kontratës. Ndryshimet e shumta të

realizuara kanë bërë që vlera e mësipërme të prokurohet drejtpërdrejtë pa procedurë prokurimi. Ndryshimet dhe shtesat në kontrata janë procese të lejuara, por kur ato rezultojnë me vlera të larta, kanë të bëjnë me punime që ndryshojnë për nga lloji i punimeve të parashikuara, japin efekte negative kryesisht sa i përket kostos së përfitimit të tyre. Ky veprim vjen si pasojë e mos parashikimit të duhur të nevojave për ndërhyrje, si dhe i vonesave në realizimin e kontratave (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1-Rekomandimi:-** Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Bashkia Tiranë, për projekte të cilat janë në plane për të ardhmen, të marrin masa për realizimin e studimeve të mirëfillta dhe të detajuara të nevojës për ndërhyrje me investime, me synim uljen e mundësisë për ndryshime gjatë zbatimit të kontratave. Në rastet e kontratave komplekse, në preventivat përkatës duhet të përfshihen si njësi edhe punime të cilat nuk janë pjesë e projektit, për të përfituar çmime sa më të favorshme të cilat dalin nga realizimi i garës.

### *Vazhdimisht*

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit janë verifikuar disa zëra punimesh në objekt për Kontratën “Rehabilitimi i Lumit të Tiranës, kryesisht për punime të dukshme. Përgjatë lumit janë realizuar punime të cilat rezultojnë se kanë pësuar dëmtime kryesisht në mbrojtjen e brigjeve me shkëmbinj (boulders), mureve prej gabioni, bordurave prej betoni, shtresave dhe gjelbërimit. Përgjatë brigjeve të lumit, konstatohet hedhje inertësh, duke shkaktuar dëmtim të sipërfaqeve të gjelbra. Mos ndërhyrja në kohën e duhur për mirëmbajtjen e punimeve do të bëjë që punimet të degradojnë më tej. Me përfundimin e punimeve dhe përfundimin e periudhës së garancisë, mirëmbajtja e investimit kalon drejtorive përkatëse të punëtorëve sipas territorit që mbulojnë. Sa i përket infrastrukturës së ujësjellësit, administrimi dhe mirëmbajtja kalojnë në përgjegjësinë e Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1-Rekomandimi:-** Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve nr. 1 dhe nr. 2, pranë Bashkisë Tiranë, të marrin masa për hartimin dhe zbatimin e një plani masash për ndërhyrje dhe riparimet e nevojshme të punimeve të dëmtuara përgjatë Lumit të Tiranës (zona e kontratës), në mënyrë që të shmangët rritja e kostos për ndërhyrje në të ardhmen nga degradimi i mëtejshëm i punimeve të kryera.

### *Vazhdimisht*

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të kontratës së ndërtimit të bulevardit, janë verifikuar disa zëra punimesh në objekt, kryesisht me punime të realizuara dhe nuk janë bërë të dukshme.

- Sipas zërit J.01.12/7P.p “Furnizim mbjellje pisha (Pinus pinea)”, u verifikuan të gjitha pemët e mbjella në sasinë 278 copë, certifikuar me vlerë 431,595 Euro,, nga të cilat rezultuan të thara 6 copë, me vlerë 9,470 Euro. Gjatë fazës së auditimit në terren, nga ana e Kontraktorit janë marrë masa për zëvendësimin e tyre.

- Nga verifikimi i zërit L NP.02 “F.V Gardh metalik me rrjetë”, rezultoi se është në pjesën e dytë të bulevardit ka dëmtime të bazamentit të rrjetave, kryesisht nga veprimet e kalimtarëve, duke ulur qëndrueshmërinë e rrethimit.

-Nga verifikimi i punimeve sipas zërit L.NP.03 “Furnizim vendosje banera” rezultoi se janë dëmtuar 200 copë banera. Realizimi i tyre identifikohet nëpërmjet dokumentacionit të projektit.

- U verifikuan zërat e punimeve shtrim me pllaka, shtresa asfaltime, realizimi i ndriçimit, nga ku nuk rezultuan mangësi. Punimet e kësaj kontrate, përjashtuar një segment me gjatësi 370 m,



nuk janë marrë akoma në dorëzim nga Bashkia Tiranë dhe rehabilitimi i punimeve të dëmtuara është në përgjegjësi të Kontraktorit (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1 Rekomandimi:-** Njësia e Zbatimit të Projektit t'i kërkojë Kontraktorit riparimin e punimeve të dëmtuara dhe zëvendësimin e banerave të hequr përgjatë rrethimit të bulevardit, duke qenë se punimet janë në periudhën e riparimit të defekteve dhe në përgjegjësi të kontraktorit.

*Menjëherë*

## C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zbatimit të kontratave të këtij projekti janë bërë ndryshime të shumta të cilat kanë në përbërje edhe punime të cilat nuk janë pjesë e preventivit. Referenca për çmimet e aplikuar kryesisht është bazuar në manualët e çmimeve të ndërtimit. Në kontratë përcaktohet se kur nuk ka çmime në manuale, referenca duhet të merret për punime të ngjashme. Sipas zërit 7.0 NPN 24 'Furnizim vendosje bordura (6 x 20) cm' (kontrata e rehabilitimit të Lumit Tiranë) është aplikuar çmimi 3.32 Euro për ml. Nga verifikimi dhe krahasimi i kostos së përlogaritur sipas zërit 3.619 a, për bordura me përmasa (6 x 20) cm, çmimi paraqitet 435 lekë për ml, ose 3.107 Euro për ml. Sa më sipër, megjithëse në manual ka referencë të saktë, çmimi i aplikuar është bazuar në zëra të tjerë të ngjashëm. Ky veprim është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.3.b "Vlerësimi". Sasia e realizuar është në masën 17749 ml. **Vlera 3,780 Euro [17749 ml x (3.32 – 3.107)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik** (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1-Rekomandimi:-** Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve të marrin masa për reduktimin e **vlerës 3,780 Euro**, nga vlera e garancisë së punimeve, për Kontraktorin bashkimin e operatorëve ekonomikë "T. E. 2" SHPK dhe "S. AG" Austria.

*Menjëherë*

## C. 2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për kontratën e ndërtimit të bulevardit verior ka patur vonesa të cilat kanë ardhur si pasoje e realizimit të procesit të shpronësimit për interes publik, ndryshimet e projektit, përshtatjen me planin e zhvillimit etj. Në kontratën e zbatimit përcaktohen edhe shpenzime për shërbime të cilat janë mbi bazë mujore, sipas periudhës së zbatimit. Zgjatja e kohës së zbatimit të kontratës shoqërohet edhe me rritjen e shpenzimeve si më sipër, të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtje dhe operim automjetesh, pagesa për drejtues automjetesh, mirëmbajtje dhe operim i zyrave në dispozicion të konsulentit, etj., vlera të cilat përfshihen në kontratën e punimeve civile, por shkojnë në ndihmë të aktivitetit të konsulentit kryesisht. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve është bërë nga mos sigurimi i sheshit të ndërtimit kontraktorit për përfundimin e punimeve për një kohë të konsiderueshme.

Vlera e shpenzuar për këto shërbime në shumën **635,998 Euro**, përbën rritje të kostos së projektit (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1-Rekomandimi:-** Për projektet në të ardhmen, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Bashkia Tiranë të marrin masa për realizimin e procesit të shpronësimit për interes publik, para fillimit të punimeve, me synim shmangien e vonesave të cilat shkaktojnë kosto shtesë për projektin.

#### *Vazhdimisht*

**2. Gjetje nga auditimi:** Shtesa e kontratës së shërbimeve konsulente nr. 3, nr. 34201 prot., është miratuar me datë 09.11.2016. Kjo shtesë ka të bëjë me aprovimin e pagesës së ekspertëve staf të konsulentit, për kohë shtesë mbi orarin e punës si dhe ditë ekstra, me miratimin e punëdhënësit, konkretisht me ndryshimin e nenit 34 të kontratës. Neni 34, pika 2, e kushteve të Përgjithshme të Kontratës përcaktohet: *“Ekspertët nuk do të kenë të drejtë të paguhen për mbi kohë pune, të marrin pagesa për largime për arsye shëndetësore, ose pushime përveç sa përcaktohet në Aneksin B dhe pagesat për punë ekstra, konsiderohen të përfshira në këtë aneks”*. Në periudha të veçanta të zbatimit të punimeve punohet me orar të zgjatur dhe në këto kushte kërkohet edhe prezenca e punonjësve të mbikëqyrësit të punimeve edhe mbi kohën normale të punës.

Bazuar në kontratën bazë, pagesa për qëndrim në punë mbi kohën normale të punës si dhe puna në ditë ekstra, konsiderohet e përfshirë në pagesën e paraqitur në dokumentet e tenderit (propozimi financiar), mbi bazë mujore (njerëz/muaj).

Shtesa nr. 3 e kontratës së shërbimeve konsulente, është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 34, pika 2, si dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës neni 34.

**Vlera 204,620 Euro, e cila përfaqëson shërbime mbi kohë normale të punës është në kundërshtim me kontratën bazë të miratuar dhe përbën efekt negativ financiar** (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1-Rekomandimi:-**Njësia e Zbatimit të Projektit për projekte në vijimësi, duhet të eliminojë praktikën e mos monitorimit dhe kontrollit financiar të shpenzimeve.

#### *Vazhdimisht*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i punimeve sipas kontratës së rehabilitimit të Lumit të Tiranës rezulton se sipas zërit të ri të punimeve NPN02, është përlllogaritur çmimi për shtresë betoni në mbështetje të tombinove drejtkëndore 9,886 lekë/m<sup>3</sup>, ose 70.6 Euro/m<sup>3</sup> sipas analizës 3.240, e cila përfaqëson punime strukturash. Punimet e betonit për vendosjen e tombinove katrore kanë të bëjnë me një shtresë 10 cm dhe jo me strukturë betoni. Referenca e çmimit është e gabuar. Për zërin e punimeve shtresë betoni C 12/15, çmimi paraqitet në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit (2013) 2.262/3 ‘Shtresë betoni C 12/15’, në shumën 8,979 lekë për m<sup>3</sup>, ose 64.1 Euro për m<sup>3</sup>. Manuali nr. 2, i cili i referohet ndërtesave, ka në përshkrime shtresa betoni por për sasi të vogla, ndryshe nga manuali nr. 3, i cili e referohet infrastrukturës që në përgjithësi rezulton me volume të mëdha të punimeve për të cilat kosto ulët. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve duhet të merrej në konsideratë çmimi i paraqitur në manualin nr. 2, pasi volumi i punimeve të betonit të varfër nuk është me volume të konsiderueshme. Pavarësisht se manuali nr. 2, i përket ndërtesave dhe çmimi nuk mund të referohet pa marrë në konsideratë volumin dhe shtrirjen, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve duhet të kërkohet një analizë e detajuar e kostos për këtë zë punimi. **Vlera 22,028 Euro [3389 m<sup>3</sup> (70.6 Euro – 64.1**

*Euro)], konsiderohet efekt negativ financiar (Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1-Rekomandimi:-** Njësia e Zbatimit të Projektit, për projektet në vijimësi, të kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve analizimin e saktë të kostove të punimeve të ndërtimit për punime të cilat nuk janë parashikuar në preventivin e tenderuar, si dhe nuk kanë referencë të drejtpërdrejtë në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit.

*Vazhdimisht*

**4. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit u verifikuan disa zëra punimesh të realizuara në objektin rehabilitim i Lumit të Tiranës. Nga verifikimi rezultoi se ka disa dëmtime në lidhje me:

-Bordurat anësore sipas zërit të punimeve 7.0 NPN 24 në kilometër.

- Ka dëmtime të barrierave mbrojtëse të brigjeve të lumit sipas zërit nga kilometër 2 deri kilometër 5.

- Nga verifikimi i punimeve për kanalizimet e ujërave të zeza, në pjesët ku ishte e mundur, rezulton se në kilometrin 2+580, janë vendosur tombino të parapërgatitura, si dhe nuk janë mbyllur me beton fugat në pjesën e brendshme. Nga përlllogaritjet rezulton se për zërin 6.0 ‘NPN07’, është përfshirë sasia 771.5 m<sup>3</sup>, nga të cilat pjesës së brendshme i takon sasia 395 m<sup>3</sup>. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se një sasi e konsiderueshme është realizuar me beton monolit, ndërsa sasia tjetër me kombino të parapërgatitura. Në pjesët e realizuara me beton monolit, fugat e betonit janë realizuar çdo 6 m dhe jo çdo dy metër, siç janë bërë llogaritjet për betonin e vendosur në vepër. Duke qenë se nuk ka përcaktim të distancave të realizuara me beton monolit dhe tombino të parapërgatitura, u verifikuan raportet progresive nga ku konstatohet që distanca 2730 ml është realizuar me beton monolit (minimalisht). Për këtë distancë është llogaritur beton për mbylljen e fugave në sasinë 119 m<sup>3</sup>, për 1 fugë në 2 ml. Nga përlllogaritjet për fuga në çdo 6 ml, sasia e betonit e vendosur rezulton në sasinë 40 m<sup>3</sup> (119 x 1/3). Sasia 79 m<sup>3</sup> nuk është dokumentuar siç duhet në librezën e masave. Sa më sipër rezulton se për sasinë 474 m<sup>3</sup> beton (395+79), nuk janë bërë përcaktimet e duhura në librezën e masave. Veprim në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.2.a “Metoda e matjes”. Duke qenë se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të padukshme, për faktin se nga ana e mbikëqyrësit të punimeve nuk është evidentuar saktë në librezën e masave, si dhe për faktin se nga grupi i auditimit është bazuar në dokumentacion (fotografi), ***vlera 15,120 Euro [(474 m<sup>3</sup> x 31.9 Euro/m<sup>3</sup>)] konsiderohet efekt negativ financiar (Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).***

**4.1-Rekomandimi:-** Njësia e Zbatimit të Projektit si dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për shqyrtimin e ndryshimit të metodikës së realizimit të punimeve të betonit për kanalizimet, duke shqyrtuar edhe koston e realizimit të tyre. Pas analizës përkatëse, të ndiqet në rrugë ligjore dhe t’i kërkohej kontraktorit kompensimi i dëmeve të shkaktuara.

*Deri me 31.12.2020*

**5. Gjetje nga auditimi:** Me pagesën nr. 1, sipas kontratës së rehabilitimit të Lumit të Tiranës, është likuiduar vlera 8,587 Euro për pagesë takse vend depozitim mbeturinash dhe sipas zërit 2.1 PN33 dhe vlera 4,333 Euro sipas 2.2 PN34.

Sipas certifikatës së pagesës nr. 02, datë 02.05.2014, pagesa sipas zërit 2.1 PN33 është reduktuar përkatësisht në 1,669.3 Euro (8,587 - 6,917 Euro), ndërsa sipas zërit 2.2 PN34 në

1,114.2 Euro (4,333-3,218 Euro). Sipas certifikatës nr. 5, datë 05.06.2015, pagesat për taksë vend depozitimi janë reduktuar në zero. Këto pagesa janë rikthyer sipas certifikatës nr. 18, datë 18.05.2017. Pagesa është realizuar pa paraqitjen e faturave të pagesës nga ana e Kontraktorit megjithëse është paraqitur një kontratë depozitimi me tarifa pagese. Ku veprim është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.1. **Pagesa me vlerë 12,920 Euro [8,587 Euro+4,333 Euro], pasi nuk është plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe konsiderohet efekt negativ financiar** (Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1-Rekomandimi:** - Nga ana e Njesisë së Zbatimit të projektit dhe Mbikëqyrësit të Punimeve të reflektohen sasitë e materialeve të dala nga gërmimet dhe dërguar në vend depozitim. T'i kërkohet kontraktorit paraqitja e dokumentacionit të pagesave për vend depozitime. Në mungesë të paraqitjes së dokumentacionit, për të cilin pretendon se e disponon, të merren masa në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës përkatëse.

**5.2-Rekomandimi:** -Për projektet në të ardhmen, Njësia e Zbatimit të Projektit duhet të kërkojë dhe verifikojë me detaje çdo dokument pagese, për të shmangur pagesa të cilat rëndojnë padrejtësisht buxhetin e bashkisë.

*Menjëherë dhe vazhdimisht*

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Ne lidhje me mangësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, grupi i auditimit konsideron se gjetjet nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë propozim për fillim mase disiplinore për stafin e Njesisë së Zbatimit të Projektit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

**Arben SHEHU**

**K R Y E T A R**